

MONITORIMI I MEDIAS

Narrativat Dominuese mbi Integrimin në BE në Mediat Digjitale Shqiptare

Analizë e temave, kornizave, toneve dhe narrativave në mbulimin mediatik të procesit të anëtarësimit

Përmbajtja

1. Konteksti

2. Metodologjia

Përzgjedhja e artikujve për monitorim

Periudha e monitorimit

Kodimi

3. Gjetjet Kryesore

Temat Kryesore

Kornizimi (Framing) Dominues

Tonet

4. Narrativat Dominuese

Narrativa A: Reformat si rruga drejt integritit

Narrativa B: Shqipëria nuk është ende e gatshme

5. Aneks

Bibliografia

1. Konteksti

Integrimi dhe anëtarësimi në BE ka qënë prej kohësh një angazhim afatgjatë dhe një objektiv strategjik i Shqipërisë, duke u konsideruar gjerësisht si prioriteti kryesor i vendit.¹ Që nga aplikimi për anëtarësim në Bashkimin Evropian në vitin 2009 dhe marrjes së statusit të vendit kandidat në vitin 2014, procesi i anëtarësimit ka shërbyer si një nxitës kryesor i reformave të lidhura me BE-në, duke përfshirë të drejtat themelore, shtetin e së drejtës, integrimin dhe zhvillimin ekonomik, si edhe qeverisjen demokratike në përgjithësi.² Përgjatë qeverive të njëpasnjëshme, objektivi kombëtar i integrimit evropian ka mbetur në qendër të prioritetëve politike, me një theks të vazhdueshëm mbi përafrimin me Bashkimin Evropian në të gjitha fushat, përfshirë politikën e përbashkët të jashtme dhe të sigurisë, si edhe *acquis communautaire* të BE-së.³ Dinamika pozitive e këtij procesi u përforcua më tej me nisjen e negociatave të anëtarësimit në vitin 2022 dhe hapjen e të gjashtë grupkapitujve të negociatave ndërmjet tetorit 2024 dhe nëntorit 2025.⁴

Së fundmi, në maj të vitit 2026, Shqipëria u bë vendi i dytë kandidat që mori miratimin e Raportit të Vlerësimit të Përkohshëm të Piketave (IBAR) për grupkapitullin “Themeloret,” duke hyrë kështu në fazën përmbyllëse të procesit të anëtarësimit.⁵ Si rezultat, Shqipëria konsiderohet si një nga vendet candidate që po përparon më shpejt drejt Bashkimit Evropian, me objektivin ambicioz për të përfunduar negociatat e anëtarësimit deri në vitin 2027 dhe për t’u bërë anëtare me të drejta të plota në vitin 2030.⁶

Përtej dimensioneve të tij institucionale dhe procedurale, procesi i integrimit evropian është thellësisht i ndërthurur me politikën e brendëshme, ndërsa mbështetja për anëtarësimin në BE mbetet jashtëzakonisht e lartë si një objektiv i përbashkët kombëtar. Opinioni publik është vazhdimisht pozitiv: një sondazh i Komisionit Evropian të vitit 2025 tregoi se mbështetja për anëtarësimin e Shqipërisë në Bashkimin Evropian ishte më e larta në rajon, me 91%.⁷ Gjithashtu, Shqipëria u rendit e para ndër vendet me perceptimin më pozitiv për BE-në, me 82%.⁸ Në këtë kuptim, objektivi i përgjithshëm i integrimit dhe anëtarësimit në BE përbën një nga pikat e rralla/pakta të konsensusit shoqëror në një mjedis politik dhe mediatik zakonisht të karakterizuar nga polarizimi.

Megjithatë, pavarësisht këtij konsensusi të gjerë politik mbi objektivin e integritit, ekzistojnë dallime të konsiderueshme dhe pika të forta përplasjeje ndërmjet qeverisë dhe opozitës në mënyrën se si vlerësohet procesi i anëtarësimit dhe rruga për arritjen e tij. Këto dallime shprehen kryesisht përmes diskursit politik dhe transmetohen në hapësirën publike nëpërmjet raportimit mediatik. Këto interpretime të polarizuara ndikojnë drejtpërdrejt në mënyrën se si publiku e kupton dhe e percepton procesin e integritit evropian, duke formësuar njëkohësisht mjedisin informativ dhe politik në vend, përfshirë edhe vendimmarrjet që lidhen me procesin e integritit. Për këtë arsye, është e rëndësishme që integrimi evropian të analizohet brënda kontekstit më të gjerë politik dhe komunikues, duke shqyrtuar këto interpretime konkurruese.

Në këtë kontekst, media shërben si ndërmjetësi kryesor përmes të cilit këto interpretime konkurruese të integritit evropian komunikohen te publiku. Qytetarët njihen dhe ndërveprojnë me procesin e integritit, që ndryshe është një proces kompleks, teknik dhe shumëdimensional, kryesisht përmes raportimit mediatik dhe komunikimit politik. Kështu, mënyra se si zhvillimet dhe vlerësimet e ndryshme për procesin e anëtarësimit përzgjidhen, kontekstualizohen dhe paraqiten, ndikon drejtpërdrejt në diskursin publik. Monitorimi sistematik i medias përbën, për këtë arsye, një instrument për identifikimin dhe analizimin e narrativave, kornizave interpretuese, temave dhe toneve dominuese përmes të cilave paraqitet procesi i integritit në një mostër të larmishme të medias digitale shqiptare.

Për rrjedhojë, ndërsa mbështejta politike dhe publike për integrimin evropian si një objektiv strategjik është tashmë e njohur, ky raport fokusohet në interpretimet e ndryshme të vetë procesit të integritit dhe anëtarësimit në BE. Synimi i tij është të ofrojë një kuptim më të thellë të mjedisit informativ dhe politik që shoqëron një nga prioritetet më të rëndësishme kombëtare të Shqipërisë.

-
1. Directorate-General for Enlargement and Eastern Neighbourhood, "Communication on EU Enlargement Policy: Albania 2025 Report" (Brussels: European Commission, November 4, 2025), 3, https://enlargement.ec.europa.eu/albania-report-2025_en.
 2. Directorate-General, "Communication on EU Enlargement," 3.
 3. Ibid, 92.
 4. Wouter Zweers, "Albania's EU Accession Sprint: Balancing Momentum, Reform, and EU Scrutiny," Clingendael Netherlands Institute of International Relations, December 3, 2025, 1, <https://www.clingendael.org/publication/albanias-eu-accession-sprint-balancing-momentum-reform-and-eu-scrutiny>.
 5. Dimosthenis Mammonas, "Enlargement: Albania Meets Interim Benchmarks for Fundamentals Cluster," Council of the European Union, May 26, 2026, 1, <https://www.consilium.europa.eu/en/press/press-releases/2026/05/26/enlargement-albania-meets-interim-benchmarks-for-fundamentals-cluster/>.

6. Zweers, "Albania's EU Accession," 2.
7. Directorate-General for Enlargement and Eastern Neighbourhood, "Majority of EU Citizens Support Further EU Enlargement, New Eurobarometer Survey Shows, While Perception Surveys in Candidate Countries Point to Overall Support for EU Accession," Enlargement and Eastern Neighbourhood (European Commission, September 2, 2025), https://enlargement.ec.europa.eu/news/special-eurobarometer-and-perception-surveys-2025-09-02_en.
8. Directorate-General, "Majority of EU Citizens."

2. Metodologjia

Ky raport synon të monitorojë diskurset dominuese mbi integrimin evropian në median dijitalë shqiptare, për t'iu përgjigjur pyetjeve të mëposhtme kërkimore:

- Si paraqitet dhe kornizohet integrimi evropian në median shqiptare?
- Cilat janë temat, tonet, dhe narrativat dominuese që karakterizojnë këtë mbulim mediatik?

Në kuadër të këtij studimi u përzgjedhën 10 media shqiptare me platforma online, duke përfshirë televizione (Top Channel, TV Klan, Syri); gazeta (Gazeta Panorama, Gazeta Tema); portale dijitalë me audiencë të lartë (Lapsi, Shqiptarja.com, Balkanweb); si edhe platforma të pavarura të verifikimit të fakteve dhe llogaridhënies publike (Faktoje, Citizens Channel). Përzgjedhja e këtyre mediave u bazua në një strategji kampionimi të qëllimshëm, e projektuar për të përfaqësuar një seksion sa më të gjerë të ekosistemit bashkëkohor mediatik shqiptar.

Kjo qasje karakterizohet nga dy elemente kryesore. Së pari, garanton diversitet burimesh duke kombinuar mediat tradicionale me shtrirje të gjerë kombëtare me platforma dijitalë vendase; së dyti, pasqyron pluralizmin politik të ekosistemit mediatik shqiptar, duke përfshirë media të afërta me qeverinë, pranë opozitës, me qëndrim centrist, si edhe media të pavarura ose alternative.

Përzgjedhja e artikujve për monitorim

Mjeti Google Advanced Search u përdor për përzgjedhjen e 40 artikujve për monitorim. Rezultatet e kërkimit u kufizuan vetëm në artikuj të publikuar nga 10 mediat e përzgjedhura gjatë periudhës 15 maj – 15 qershor 2026. Për identifikimin e artikujve që trajtonin në mënyrë specifike integrimin evropian u përdorën fjalët kyçe:

- | | |
|----------------------------|------------------------|
| • BE / EU | • Komisioni Evropian / |
| • Integrim / integration | European Commission |
| • Negociata / negotiations | • Bruksel / Brussels |
| • Kapituj / chapters | • IBAR |

Fjalët kyçe përfshinin terminologji të pergjithshme mbi integrimin, emërtime të institucioneve kryesore evropiane, si edhe tregues teknikë e proceduralë të procesit të anëtarësimit. U përdorën si versionet shqip ashtu edhe ato në anglisht, për të përfshirë edhe publikimet në gjuhën angleze të mediave shqiptare, si Citizens Channel.

Për të shmangur kufizimin e tepërt të rezultateve, fjalët kyçe u kombinuan duke përdorur operatorin logjik “OR”. Kjo strategji siguroi që artikujt të përfshiheshin në rezultatet e kërkimit nëse përmbanin të paktën një nga fjalët kyçe në titull ose në përmbajtje, pa qenë e nevojshme të përmbanin të gjitha termat.

SHEMBULLI I KËRKIMIT

Site: top-channel.tv (“BE” OR “EU” OR “negociata” OR “negotiations” OR “kapituj” OR “chapters” OR “IBAR” OR “Komisioni Europian” OR “European Commission” OR “Bruksel” OR “Brussels”)
Custom Range: May 15, 2026 – June 15, 2026.

Kërkimi fillestar gjeneroi mbi 80 artikuj që trajtonin integrimin evropian. Megjithatë, më shumë se gjysma e tyre riprodhonin pothuajse identikisht të njëjtën përmbajtje ose raportin mbi të njëjtat zhvillime me dallime minimale në kornizim, ton, apo narrativë. Ky fenomen pasqyron një karakteristikë të njohur të mjedisit mediatik shqiptar, ku lajmet ripublikohen shpesh nga një media në tjetrën me shumë pak ndryshime editoriale, praktikë e njohur si *copy-paste journalism*.⁹

Një proces përzgjedhjeje u realizua nga një studiues për të shmangur mbipërfaqësimin e të njëjtave ngjarje dhe fryrjen artificiale të frekuencës së temave, kornizave, toneve apo narrativave të caktuara. Artikujt me përmbajtje të mbivendosur ose që trajtonin të njëjtën ngjarje u krahasuan, ndërsa një artikull i vetëm u ruajt për analizë dhe kodim të mëtejshëm. Përparësi iu dha artikullit që ofronte mbulim më të plotë, kontekst më të gjerë, raportim origjinal ose analizë më të detajuar të procesit të integritetit evropian. Kur ishte e mundur, artikujt u përzgjodhën nga media të ndryshme për të garantuar diversitet burimesh dhe për të shmangur mbipërfaqësimin e një mediumi të vetëm.

Periudha e monitorimit

Periudha e monitorimit, që përfshin artikujt e publikuar midis 15 maj dhe 15 qershor, 2026, u përzgjedh për shkak të përqëndrimit të zhvillimeve të rëndësishme në procesin e anëtarësimit të Shqipërisë në Bashkimin Evropian. Gjatë kësaj periudhe u shënuan disa momente kyçe, përfshirë marrjen e raportit pozitiv IBAR për grupkapitullin “Themeloret,” zhvillimin e Konferencës Ndërqeveritare, Samitin BE-Ballkani Perëndimor, vizitat e drejtuesve të lartë të Bashkimit Evropian, përfshirë Presidentin e Këshillit Evropian, si edhe rifillimin e diskutimit rreth afatit kohor të anëtarësimit të Shqipërisë.

Njëkohësisht, levizja qytetare të Flamingove, e cila filloi në fund të majit, tërhoqi vëmendjen e institucioneve evropiane dhe nxiti diskutime të reja mbi procesin e integritetit, duke rritur ndjeshëm edhe mbulimin mediatik. Për këtë arsye, kjo periudhë ofroi një kampion të pasur për analizimin e narrativave, kornizave interpretuese, toneve, dhe temave dominuese që karakterizojnë diskursin mediatik mbi integritetin evropian.

Vendimi për ta kufizuar monitorimin në një periudhë njëmuajore u diktua gjithashtu nga konsiderata metodologjike dhe praktike. Duke marrë parasysh volumin e madh të përmbajtjes së medias digjitale dhe nevojën për analizë sistematike të secilit artikull sipas temave, kornizave, toneve dhe narrativave, një periudhë e përcaktuar mundësoi një analizë më të fokusuar dhe më konsistente. Në këtë mënyrë, periudha e përzgjedhur arrin një ekuilibër ndërmjet thellësisë analitike dhe realizueshmërisë së studimit, duke kapur njëkohësisht një fazë veçanërisht dinamike të procesit të integritetit të Shqipërisë në Bashkimin Evropian.

Kodimi

Kampioni përfundimtar prej 40 artikujsh u kodua nga një studiues i vetëm duke përdorur Microsoft Excel, me qëllim identifikimin e temave kryesore, kornizave interpretuese, toneve dhe narrativave dominuese në lidhje me integritetin evropian. Duke përdorur kategori të parapërcaktuara, secilit artikull iu caktuan deri në dy kode për secilën kategori, për të ruajtur nuancat analitike pa fragmentuar rezultatet. Në rastet kur ishin të mundshme interpretime të shumëfishta, kodimi u bazua në karakteristikat dominuese të artikullit.

TEMAT KRYESORE

Fokusi dhe / ose tema dominuese e artikullit në lidhje me integrimin evropian:

- Gatishmëria dhe afati kohor
- Negociatat e anëtarësimit
- Lufta kundër korrupsionit
- Ekonomia dhe Tregu i Përbashkët
- Shteti i së drejtës dhe reforma në drejtësi
- Hapja edhe / ose mbyllja e kapitujve të negociatave
- Mjedisi dhe Axfenda e Gjellber
- Zgjedhjet dhe standartet demokratike
- Bujqësia dhe zhvillimi rural

KORNIZIMI (FRAMING)

Mënyra se si paraqitet integrimi evropian në median digjitale shqiptare, si:

- Proces politik
- Proces teknik reformash
- Çështje gjeopolitike
- Mundësi ekonomike
- Projekt simbolik edhe / ose i identitetit kombëtar

TONI

Toni me të cilin trajtohet procesi i integrimit evropian:

- Pozitiv edhe / ose optimist
- Skeptik
- I polarizuar
- Neutral edhe / ose analitik
- Negativ edhe / ose alarmues

NARRATIVAT

Narrativat dhe diskutimet dominuese mbi integrimin evropian, duke qënë:

- Integrimi evropian si histori pozitive / suksesi
- Integrimi evropian si presion i jashtëm
- Hipokrizia e Bashkimit Evropian dhe / ose lodhja nga zgjerimi
- Integrimi evropian si instrument politik
- Shqipëria nuk është ende gati për Evropën
- Evropa nuk është ende gati për Shqipërinë
- Reformat si rruga drejt integrimit

3. Gjetjet Kryesore

Seksioni në vijim paraqet gjetjet kryesore të analizës lidhur me temat dhe çështjet dominuese, mënyrat e kornizimit (framing) dhe tonin e artikujve të monitoruar mbi procesin e integrimit.

Temat Kryesore

Në kontekstin e integrimit evropian, analiza tematike identifikon çështjet kryesore që dominojnë mbulimin mediatik. Konkretisht, ajo evidenton dimensionet e procesit të integrimit që marrin vëmendjen më të madhe në media, si edhe ato që trajtohen më rrallë. Kuptimi i prioriteteve tematike të raportimit mediatik ofron një pasqyre mbi aspektet e integrimit evropian që ndodhen në qendër të diskursit publik dhe politik.

Nga 40 artikujt e monitoruar, 20 u identifikuan dhe u koduan me fokus kryesor gatishmërinë dhe afatet kohorë të procesit të integrimit. Artikujt e klasifikuar në këtë temë trajtonin nivelin e perceptuar dhe/ose të parashikuar të gatishmërisë së Shqipërisë për anëtarësim në BE-në, si dhe ritmin dhe afatet e procesit të anëtarësimit. Në shumicën e rasteve, mbulimi mediatik i referohej vonesave ose përshpejtimit të objektivave për përfundimin e negociatave të anëtarësimit deri në vitin 2027 dhe anëtarësimit formal në Bashkimin Evropian deri në vitin 2030.




Figura 1. Temat dhe çështjet kryesore që karakterizojnë diskutimin mbi integrimin evropian.

Temat e dyta më të shpeshta ishin negociatat e anëtarësimit dhe lufta kundër korrupsionit, me përkatësisht 15 dhe 9 artikuj. Në rastin e parë, raportimi u përqëndrua në zhvillimet teknike dhe procedurale të procesit të integritit, veçanërisht rezultatet e raportit IBAR, grupkapitullin “Themeloret” dhe reformat institucionale përkatëse. Artikujt e koduar nën temën e luftës kundër korrupsionit trajtonin kryesisht reformën në drejtësi, çështjen Balluku, rolin e SPAK-ut dhe luftën e vazhdueshme kundër korrupsionit në nivelet e larta si parakusht për integrimin evropian.

Këto gjetje tregojnë se komunikimi mediatik mbi integrimin evropian dominohet nga diskutimet mbi gatishmërinë aktuale të Shqipërisë dhe progresin e procesit të anëtarësimit, të nxitura si nga zhvillime pozitive, si rezultati i IBAR-it, dhe / ose të penguara nga vështirësitë e vazhdueshme në luftën kundër korrupsionit. Në të kundërt, më pak vëmendje i kushtohet reformave sektoriale dhe politikave konkrete që lidhen me anëtarësimin, si ekonomia dhe Tregu i Përbashkët, bujqësia, politika mjedisore etij.

Kornizimi (Framing) Dominues

Ndërsa temat kryesore tregojnë se çfarë trajtohet në media, analiza e kornizimit identifikon se si ato paraqiten dhe interpretohen në mjedisin politik dhe informativ. Kornizat përmes të cilave prezantohen zhvillimet e procesit të integritit evropian ndikojnë drejtpërdrejt në mënyrën se si publiku i interpreton këto zhvillime dhe rrugën e Shqipërisë drejt anëtarësimit në tërësi. Për këtë arsye, analiza e kornizimit ofron një kuptim më të thelluar të diskursit politik dhe publik mbi integrimin evropian.

Nga 40 artikujt e monitoruar, 24 u koduan nën kornizën politike. Artikujt e klasifikuar në këtë kategori e paraqisnin integrimin evropian kryesisht si një proces politik. Konkretisht, ato vinin në fokus veprimet, vendimmarrjen dhe deklaratat e drejtuesve politikë, institucioneve shtetërore, qeverisë dhe partive politike në lidhje me procesin e anëtarësimit. Në këtë kontekst, komunikimi politik përdorej për të vlerësuar performancën e qeverisë, për të kritikuar qeverinë ose opozitën dhe për të atribuar përgjegjësi për progresin apo pengesat në procesin e integritit. Si rrjedhojë, integrimi evropian paraqitet më së shpeshti si një çështje e qeverisjes, llogaridhënies dhe konkurrencës politike.




Figura 2. Kornizat dominuese të diskutimit mbi integrimin evropian.

Korniza e dytë më e shpeshtë ishte ajo teknike, e identifikuar në 14 artikuj. Artikujt e koduar në këtë kategori e trajtonin integrimin evropian si një proces procedural dhe institucional. Konkretisht, kjo kornizë karakterizohej nga raportimi mbi zhvillimet administrative të procesit të integrimit, duke përfshirë hapjen dhe mbylljen e grupkapitujve negociues, kriteret e anëtarësimit, vlerësimet zyrtare, kërkesat për reforma dhe mekanizmat e zbatimit. Vlen të theksohet se shumica e artikujve të koduar si teknikë u koduan njëkohësisht edhe si politikë, dhe anasjelltas. Kjo tregon se diskutimet mbi aspektet teknike të procesit të integrimit zhvilloheshin shpesh në një kontekst të politizuar ose interpretoheshin përmes prizmit të politikës së brendshme.

Në krahasim me këto dy kategori, kornizat gjeopolitike, ekonomike, dhe simbolike/identitare ishin të rralla, duke u shfaqur vetëm në 3-4 artikuj secila. Kjo sugjeron se raportimi mediatik mbi integrimin evropian dominohet nga dimensionet politik dhe teknik, ndërsa diskutimet mbi implikimet afatgjata të anëtarësimit në BE në aspektin ekonomik, gjeopolitik dhe shoqëror janë dukshëm më pak të pranishme.

Tonet

Ndërsa temat dhe kornizat tregojnë se çfarë diskutohet dhe si paraqitet procesi i integrimit, po aq i rëndësishëm është edhe toni përmes të cilit ai trajtohet. Në raportimin mediatik, toni pasqyron qëndrimet, perceptimet dhe orientimet emocionale që karakterizojnë diskursin publik mbi integrimin evropian. Analiza e tonit ofron një kuptim më të thellë të mjedisit komunikues dhe emocional në të cilin zhvillohet debati publik, duke evidentuar nëse procesi paraqitet në mënyrë pozitive, negative, skeptike, të polarizuar apo neutrale. Gjithashtu, ajo ndihmon në kuptimin e

nuancave të qëndrimeve publike ndaj zhvillimeve konkrete të procesit të anëtarësimit, përtej mbështetjes së përgjithshme për anëtarësimin në BE, e cila tashmë është e mirëdokumentuar.

Nga 40 artikujt e monitoruar, nuk u identifikua një tipologji dominuese e tonit. Nga pesë kategoritë e përcaktuara, toni pozitiv/optimist dhe toni skeptik ishin më të shpeshtit, me nga 10 artikuj secili. TONI negativ/alarmues dhe toni neutral pasonin me nga nëntë artikuj secili, ndërsa toni i polarizuar ishte më pak i pranishëm, duke u identifikuar në vetëm pesë artikuj.



Figura 3. Tonet kryesore përmes të cilave trajtohet integrimi evropian.

Artikujt e koduar me ton pozitiv/optimist e paraqisnin integrimin evropian si një proces të suksesshëm, me zhvillime pozitive drejt anëtarësimit. Theksi vihej tek arritja e objektivave, progresi institucional dhe avancimi i reformave, duke e portretizuar rrugën e Shqipërisë drejt Bashkimit Evropian si të realizueshme, burim optimizmi, krenarie kombëtare edhe model për vendet e tjera kandidate. Në të kundërt, artikujt e koduar me ton skeptik vinin në diskutim progresin e procesit të integrit, duke sfiduar afatet e parashikuara, nivelin e progresit dhe besueshmërinë e deklaratave mbi procedurat e anëtarësimit. Ky ton karakterizohej gjithashtu nga dyshime lidhur me zbatimin e reformave dhe aftësinë e Shqipërisë për të përmbushur standardet institucionale të Bashkimit Evropian.

Artikujt me ton negativ/alarmues theksonin kryesisht dështimet dhe pengesat e perceptuara në procesin e integrit, përfshirë sfidat në luftën kundër korrupsionit, mangësitë në reformat demokratike dhe marrëdhëniet e tensionuara me institucionet evropiane.

Artikujt e koduar si neutralë paraqisnin zhvillimet në mënyrë kryesisht faktike dhe teknike, pa shfaqur një orientim të qartë emocional. Ndërkohë, artikujt me ton të polarizuar trajtonin integrimin evropian përmes interpretimeve politike

kundërshtuese, duke theksuar konfliktet dhe mosmarrëveshjet ndërmjet qeverisë dhe opozitës.

Shpërndarja relativisht e balancuar e këtyre toneve tregon se diskursi publik mbi integrimin evropian nuk karakterizohet nga një qëndrim i vetëm dominues. Përkundrazi, ai pasqyron një bashkëjetesë të optimizmit, skepticizmit dhe kritikës ndaj progresit të Shqipërisë në rrugën drejt Bashkimit Evropian.

4. Narrativat Dominuese

Seksioni në vijim identifikon narrativat dominuese mbi procesin e integrimit evropian që u evidentuan në kampionin e monitoruar të mediave dhe artikujve. Përtej identifikimit të temave, kornizave dhe toneve, analiza e narrativave ofron një vlerësim më të thelluar të menyrës se si procesi i anëtarësimit interpretohet në mjedisin politik dhe informativ. Konkretisht, ajo ndihmon në kuptimin e menyrës se si progresi, sfidat dhe rruga e Shqipërisë drejt anëtarësimit konceptualizohen në diskursin publik, përtej zhvillimeve të veçanta apo ngjarjeve të ditës.

Nga 40 artikujt e monitoruar, dy narrativat më dominuese ishin: (1) Reformat si rruga e domosdoshme drejt integrimit evropian dhe (2) Shqipëria nuk është ende gati për anëtarësim. Narrativat më pak të pranishme ishin ato që trajtonin mungesën e gatishmërisë të BE-së për integrimin e Shqipërisë, si edhe hipokrizinë dhe/ose lodhjen nga zgjerimi nga ana e BE-së.




Figura 4. Narrativat kryesore që karakterizojnë diskutimin mbi integrimin evropian.

Narrativa A: Reformat si rruga drejt integrimit

Narrative më dominuese e identifikuar në kampionin e monitoruar ishte “Reformat si rruga drejt integrimit,” e pranishme në 18 artikuj. Kjo narrativë është komplekse, pasi e trajton procesin e integrimit nga një këndvështrim kritik dhe jo përmes një pozicionimi të vetëm të qartë, duke ndërthurur elemente teknike, politike, ekonomike, dhe shoqërore. Në thelb, artikujt e koduar në këtë kategori e paraqesin

integrimin evropian si një proces të kushtëzuar nga aftësia e Shqipërisë për të përmbushur standardet institucionale dhe për të zbatuar reformat e nevojshme për mbylljen e grupkapitujve negociues dhe, në fund, për anëtarësimin.

Në këtë kuptim, integrimi dhe anëtarësimi nuk paraqiten si rezultate automatike, por si procese të vazhdueshme dhe të kushtëzuara nga përparimi i qëndrueshëm në fusha kyçe si shteti i së drejtës, lufta kundër korrupsionit, qeverisja demokratike dhe reforma e drejtësisë. Në thelb, narrativa argumenton se zbatimi i reformave përbën të vetmen rrugë drejt integritit dhe se progresi i arritur deri tani, megjithëse pozitiv, nuk i zëvendëson detyrimet e mbetura që institucionet shqiptare duhet të përmbushin.

Në shumicën e rasteve, artikujt që përmbanin këtë narrativë krijojnë lidhje të forta ndërmjet/midis zhvillimeve teknike të procesit të anëtarësimit, si rezultatet e IBAR-it, hapja dhe mbyllja e grupkapitujve negociues dhe vlerësimet e BE-së, dhe zhvillimeve politike të brendshme dhe ecurisë së reformave. Në këtë kontekst, vlerësimet ishin si pozitive, ashtu edhe kritike. Disa artikuj i paraqisnin reformat dhe zhvillimet institucionale si tregues të progresit, ndërsa të tjerë theksonin sfidat e vazhdueshme dhe bënin thirrje për përsheptimin e zbatimit të reformave. Kjo ishte veçanërisht e dukshme në diskutimet rreth raportit IBAR. Megjithëse rezultati pozitiv i IBAR-it u konsiderua përgjithësisht si një hap përpara, shumë artikuj paralajmëronin kundër ekzagjerimit të rëndësisë së tij, duke theksuar shqetësimet e Bashkimit Evropian lidhur me korrupsionin dhe nevojën për përmbushjen e standardeve gjithnjë në zhvillim të BE-së.

Pavarësisht disa ndryshimeve në mënyrën e trajtimit, artikujt e kësaj narrative pasqyrojnë një perceptim se procesi i integritit në Bashkimin Evropian është ende “i papërfunduar,” sipas të cilit, pavarësisht objektivave ambiciozë për anëtarësim, reformat dhe standardet institucionale mbeten ende për t’u përmbushur dhe nuk mund të anashkalohen. Si rrjedhojë, kjo narrativë tregon se procesi i integritit evropian trajtohet kryesisht përmes logjikës së kushtëzimit. Gjithashtu, kjo thekson rolin qendror të reformave si tregues i gatishmërisë së Shqipërisë për anëtarësim, si në diskursin e autorëve politikë vendas, ashtu edhe në atë të përfaqësuesve të BE-së.

Narrativa B: Shqipëria nuk është ende e gatshme

Narrativa e dytë më dominuese ishte “Shqipëria nuk është ende e gatshme,” e identifikuar në 13 artikuj të monitoruar. Artikujt e koduar në këtë kategori përqendroheshin kryesisht te mangësitë institucionale të Shqipërisë dhe progresi i pamjaftueshëm i reformave, duke e paraqitur Shqipërinë si ende të papërgatitur për anëtarësim në Bashkimin Evropian. Duke ndërthurur elemente teknike dhe politike, kjo narrativë përbën një vlerësim të nivelit aktual dhe të pritshëm të gatishmërisë së vendit, jo vetëm për të përmbushur standardet e BE-së, por edhe për t’i ruajtur ato pas anëtarësimit. Për shembull, disa artikuj trajtonin pamundësinë e një pjese të bizneseve shqiptare për t’u përshtatur me transformimet që kërkon procesi i integritetit dhe formalizimi i tregut.

Në këtë kontekst, mangësitë identifikoheshin më së shumti në fushat e korrupsionit, reformës në drejtësi dhe shtetit të së drejtës. Vlerësimet e BE-së dhe deklaratat e aktorëve politikë vendas dhe evropianë përdorëshin shpesh për të mbështetur argumentin se kushtet për anëtarësim mbeten ende të paplotësuara, pavarësisht progresit të arritur deri tani.

Ndërsa Narrativa A e trajton integrimin përmes logjikës së kushtëzimit dhe i konsideron reformat si mekanizmin e domosdoshëm të procesit të anëtarësimit, Narrativa B e vlerëson procesin duke u nisur nga një gjykim paraprak mbi nivelin aktual të gatishmërisë së Shqipërisë. Te marra së bashku, dominimi i këtyre dy narrativave tregon se raportimi mediatik mbi integrimin evropian karakterizohet më shumë nga vlerësime kritike mbi gatishmërinë e Shqipërisë dhe aftësinë e saj për të përmbushur dhe ruajtur standardet e BE-së sesa nga një optimizëm i pakushtëzuar për anëtarësimin.

5. Aneks

Tabela A. Temat dhe Çështjet Kryesore

Tema / Çështja Kryesore	Frekuenca
Gatishmëria dhe afati kohor	20
Negociatat e anëtarësimit	15
Lufta kundër korrupsionit	9
Ekonomia dhe Tregu i Përbashkët	4
Shteti i së drejtës dhe reforma në drejtësi	3
Hapja edhe / ose mbyllja e kapitujve të negociatave	3
Mjedisi dhe Axhenda e Gjellbër	3
Zgjedhjet dhe standartet demokratike	2
Bujqësia dhe zhvillimi rural	1

Tabela B. Kornizat Dominuese

Korniza	Frekuenca
Politike	24
Teknike	14
Gjeopolitike	4
Ekonomike	4
Simbolike / e identitetit kombëtar	3

Tabela C. Tonet

Toni	Frekuenca
Skeptik	10
Pozitiv / Optimist	10
Negativ / Alarmues	9
Neutral	9
Polarizues	5

Tabela D. Narrativat Dominuese

Narrativa	Frekuenca
Reformat si rruga drejt integritit	18
Shqipëria nuk është ende gati	13
BE-ja si mundësi / histori suksesi	9
Integrimi si instrument politik	7
Integrimi si presion i jashtëm	3
Hipokrizia e BE-së / lodhja nga zgjerimi	1
BE-ja nuk është ende gati	1

Bibliografia

Directorate-General for Enlargement and Eastern Neighbourhood. "Communication on EU Enlargement Policy: Albania 2025 Report." Brussels: European Commission, November 4, 2025.https://enlargement.ec.europa.eu/albania-report-2025_en.

Directorate-General for Enlargement and Eastern Neighbourhood. "Majority of EU Citizens Support Further EU Enlargement, New Eurobarometer Survey Shows, While Perception Surveys in Candidate Countries Point to Overall Support for EU Accession." Enlargement and Eastern Neighbourhood. European Commission, September 2, 2025. https://enlargement.ec.europa.eu/news/special-eurobarometer-and-perception-surveys-2025-09-02_en.

Londo, Ilda. "Changing Media Landscape, Same Persistent Problems. The Future of the Media in Albania – Facts and Trends." Our Media, January 2025, 1 - 34.<https://institutemedia.org/research-changing-media-landscape-same-persisting-problems/>.

Mammonas, Dimosthenis. "Enlargement: Albania Meets Interim Benchmarks for Fundamentals Cluster." Council of the European Union, May 26, 2026. <https://www.consilium.europa.eu/en/press/press-releases/2026/05/26/enlargement-albania-meets-interim-benchmarks-for-fundamentals-cluster/>.

Zweers, Wouter. "Albania's EU Accession Sprint: Balancing Momentum, Reform, and EU Scrutiny." Clingendael Netherlands Institute of International Relations, December 3, 2025.<https://www.clingendael.org/publication/albanias-eu-accession-sprint-balancing-momentum-reform-and-eu-scrutiny>.